



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.218/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Fejzullah Rexhepi dhe Zyhdi Haziri anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Lutfie M. Ajvazi, duke vendosur përkitazi me ankesën e Organizatës BIRN dhe IKS me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), për shkak të bërjes së fushatës zgjedhore me fëmijë të mitur, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 06 tetor 2019, në seancën e panelit të mbajtur më datë 05.10.2019, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet e bazuar ankesa Anr.218/2019 e datës 04.10.2019 e paraqitur nga Organizata BIRN dhe IKS me seli në Prishtinë, subjektit politik Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) me seli në Prishtinë, i shqiptohet dënimi me gjobë në lartësi prej 2,800.00 € (dy mijë e tetëqind) euro, për shkak të bërjes së fushatës zgjedhore me fëmijë të mitur, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

Me datën 04.10.2019, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Organizata BIRN dhe IKS me seli në Prishtinë, me të cilën pretendon se me datën 04.10.2019, rreth orës 09:30, në videon e publikuar nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), në Prishtinë, janë parë fëmijë duke bartur materiale zgjedhore, aty shihen dy fëmijë nën moshën 15 vjeçare të mbështjellë me flamuj me logo të LDK-së, kështu duke vepruar në kundërshtim me Rregulloren 20/2019 për Fushatën e Zgjedhjeve dhe Njoftimi për Ngjarjet, përkatësisht nenin 5 par. 3 pikën b).

Si provë për pretendime e tyre i kanë bashkangjitur ankesës tre fotografi.

Subjekti politik LDK, në përgjigje në ankesë të datës 05.10.2019, konsideron se shkelja është pjesërisht e bazuar, ngase në dy fotografit e bashkangjitura, ku shihen dy persona të kthyer me shpine nuk identifikohen lehtë nëse bëhet fjalë për fëmijë, ndërsa fotografia tjetër ku shihen me fytyrë dy vajza, që për këtë pretendim mund të jenë fëmijë, por moshë e tyre mund të jetë e diskutueshme.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Nga fotografit e paraqitur si provë nga parashtruesi i ankesës shihet qartë se fëmijët janë të pajisur me materiale promovuese politike të subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), veprime këto të ndaluara sipas Rregullës Zgjedhore Nr.20/2019 të datës 26.09.2019, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullës Zgjedhore Nr.13/2013, për “Fushatën e Zgjedhjeve dhe Njoftimin për Ngjarjet Politike”, respektivisht nenin 2 par.3, pika b), c) dhe d) të kësaj Rregulle, e cila dispozitë përcakton se: “ ... asnjë subjekt politik i certifikuar nuk mund të përfshinë personat të cilët nuk i kanë mbushur 15 vjet në veprimet e

mëposhtme: ...; b) bartin pankarta dhe materiale tjera promovuese gjatë aktivitetit të fushatës zgjedhore; c) të jenë pjesë aktive e materialeve promovuese politike për të shmangur etiketimin e mundshëm, ngacmimin dhe çfarëdo ndikimi tjetër negativ të tyre; d) të jenë pjesë aktive e materialeve promovuese politike në fushatë zgjedhore me qëllim për të marrë vota emocionale të elektoratit”.

Duke u nisur nga gjendja e konstatuar faktike, Paneli gjeti se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana e subjektit politik LDK, është shkelur neni 2 par.3 pika b), c) dhe d) i Rregullës Zgjedhore Nr.20/2019 të datës 26.09.2019, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullës Zgjedhore Nr.13/2013, për “Fushatën e Zgjedhjeve dhe Njoftimin për Ngjarjet Politike”, pasi që fëmijët në tubimin e fushatës zgjedhore, kanë mbajtur material promovues për subjektin politik LDK.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rethanat në rastin konkret, se subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), ka marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thotë se është njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe përkundër këtij fakti nga ana e këtij subjekti gjatë aktivitetit të fushatës zgjedhore janë përdorur personat e mitur dhe atë edhe duke mbajtur material promovues të subjektit politik LDK, gjë e cila është në kundërshtim me dispozitat e lartëcekura ligjore.

Po ashtu si rethanë, PZAP-i, e mori edhe faktin që subjektit politik në fjalë, iu dha mundësia për t’u përgjigjur në ankesë, mirëpo subjekti politik nëpërmes përgjigjes në ankesë pjesërisht e ka konsideruar të bazuar ankesën dhe pretendimin ankimor, pra shihet qartë se nuk e ka pranuar shkeljen, por realisht sipas fotove jo qartësisht vërehet një gjë e tillë dhe se kanë ndërmarr masa në parim duke kërkuar të respektohen LPZ dhe Rregullat zgjedhore, por pasi që tubimi ka përfunduar kanë pushu kushtet për ndonjë evitim, veprime këto të cilat kanë ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.218/2019 më datën 05.10.2019**

**Kryesuese e Panelit
Gyltene Sylejmani**



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.